



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Gjykata Themelore ne Prizren – Dega Dragash

Numri i lëndës: 2021:239996
Datë: 30.01.2024
Numri i dokumentit: 05258780

C.nr.199/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Sabaheta Kurteshi si gjyqtare e vetme me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit F. G. nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokateve “K. & ASSOCIATES L.L.C” nga Prishtina, Blv. D. e K. Ul. C-., ../6 hyrja 10., kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson Ramadan R. Krasniqi nga Dragashi, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, lidhur me kompensimin e avansimit ne karrier dhe zhvillim profesional, me vlerë të kontestit 5,882.6 euro, duke u kujdesuar sipas detyrës zyrtare lidhur më kompetencën lëndore, jashtë seance me datë 30.01.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Shpallet jo kompetente në pikëpamjet lëndore Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Dragash, për të vendosur në këtë çështje kontestimore.

II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, shkresat lëndës t’i dërgohen, Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Administrative, si gjykatë me kompetencë lëndore.

A r s y e t i m

Paditësi përmes Shoqërisë së avokatëve “K.&Associates L.L.C” nga Prishtina, me padinë e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, ka kërkuar nga gjykata miratimin e kërkesëpadisë për kompensimin e avancimit në karrier – lincenca dhe zhvillim profesional.

Pas shqyrtimit të padisë dhe shkresave tjera të lëndës, gjykata konstatoi se kompetenca lëndorë për të vendosur në këtë çështje juridike është e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Administrative, si gjykatë me kompetencë lëndore.

Bazuar nga shkresat e lëndës dhe nga përmbajtja e padisë rezulton se paditësi është i punësuar tek e paditura në pozitën e sekretarit të shkollës në SHFMU “ Sh. Sh.” në Ll., Komuna e Dragashit, pozitë kjo e cila hynë në kategorinë e nëpunësve civil, çka nënkupton se paditësi është i punësuar në bazë të Ligjit për Shërbyesit Civil dhe e ka statusin e nëpunësit civil, pra sekretar shkolle, pasi që i njëjti nuk bënë pjesë në kategorinë e punonjësve publik të cilët nuk janë pjesë e shërbimit civil referuar dispozitës së nenit 4 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbyesit Civil, ligj ky i cili ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi kërkon realizimin e të drejtave nga marrëdhënja e punës, përkatësisht kompensimit të shpenzimeve të avancimit në karrier dhe zhvillim profesional – licencimit.

Me dispozitës e nenit 18.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore është paraparë se “Gjykata sipas detyrës zyrtare, gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hynë ose jo në kompetencën gjyqësore”, ndërsa sipas dispozitës së nenit 19 të po të njëjtit ligj, është paraparë se: “Secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore”, ndërsa sipas dispozitës së nenit 392 par. 1 pika (b) të po të njëjtit ligj, është paraparë se:”Pas shqyrtimit paraparak të padisë gjykata me aktvendim shpallet jokompetente dhe lëndën ia dërgon gjykatës kompetente...”, po që se konstaton se nuk është e kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes”.

Ng arsyet e cekura më lartë dhe në bazë të nenit 17 të Ligjit për Gjykatat, nenit 18 par. 1, nenit 19 dhe nenit 392 par. 1 pika (b) të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
DIVIZIONI CIVIL
2021:239996, 30.01.2024

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.